QENDRA PER SHERBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 25921
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 14/08 2024
KAMENICË/A

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA E KAMENICËS**
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

---

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02 Nr.312, datë: 13.08.2024**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 523.20 €**

1. Lejohet pagesa e faturës Nr. 2020251 të datës 02.08.2024, me Nr fiskal 810328098 në shumë prej 523.20 € për shpenzimet e krijuara në Hotel Restaurant Jehona A.G SH.P.K në Kamenicë, Shpenzimet përfshijnë ushqim dhe pije për të pranishmit në homazhet me rastin e 23 vjetorit të rënies Heroike të Rahim Beqirit - Komandant Roki.

2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 16029 i Zyrës së Kryetarit, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për Faturën, dhe fatura: Nr. 2020251 të datës 02.08.2024 në shumë prej 523.20 €.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendim t`i dërgohet:***
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DFB-së ;dhe
- Arkiv.

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 25924
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 14/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.nr.314 datë:13.08.2024**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. CAKTOHET, **z. Blerim Morina** , Zyrtar Autorizues për Projektin: **"Pritoret e autobusëve - Ritenderim''.**

2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.

3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon inicimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për inicimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.

4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Morina,** për Projektin: **"Pritoret e autobusëve - Ritenderim''.**

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Blerim Morina; dhe
- Arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE Q...
CENTAR ZA USLUGU GRA...ANA
Sh. Nr.
U. 02 Br. 26173
Nr. i faq. Data:
Br. str. 1 Datum: 16/08.
KAMENICE/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.320 datë:15.08.2024**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.26011 e datës 14.08.2024, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"LOT 1 – Asfaltimi i Rrugëve Komunale Pjesa I"**, me numër të kontratës **KM653-24-5094-5-1-1**, si në vijim:

   1.1. **z. Leotrim Spahiu** (Konsulent) , CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2 **znj. Vlonë Matoshi** (Konsulente), CAKTOHET mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***T'i dërgohet:***
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Leotrim Spahiu (Konsulent);
- znj.Vlonë Matoshi (Konsulente); dhe
- QSHQ-arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE Q...
CENTAR ZA USLUGU GRA...
Sh. U. 02 Nr. Br. 26129
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 16.08.2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.315 datë:15.08.2024**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.25997 e datës 14.08.2024, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Konsulent për planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve"**, me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**, si në vijim:

    **1.1. z. Mexhid Zylfiu** (DUPH) , CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

    **1.2 z. Mehmet Thaçi** (DUPH), CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*T'i dërgohet:*
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Mexhid Zylfiu (DUPH);
- z.Mehmet Thaçi (DUPH); dhe
- QSHQ-arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26340
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 19/08
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.325 datë: 19.08.2024**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. CAKTOHET, **z. Blerim Morina ,** Zyrtar Autorizues për Projektin: **''Participimi me donatore, Ndërtimi i Lugut të Verdhë - Ritenderim''.**

2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.

3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon inicimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për inicimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.

4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Morina,** për Projektin: **''Participimi me donatore, Ndërtimi i Lugut të Verdhë - Ritenderim''.**

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Blerim Morina; dhe
- Arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26548
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 20/08. 2024
KAMENICE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.329 datë:20.08.2024**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), neni 22 pika 22.1 Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dhe nenit 70 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Email-it Zyrtar të datës 08.08.2024 nga Menaxherja e Kontratës znj.Vjollcë Kryeziu për kërkimin e ndryshimin e sasive të pozicioneve, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Hartuesi i Projektit Arhiko ING e datës 12.08.2024, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Mbikqyrësi i Menaxheres së Kontratës e datës 19.08.2024, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës e datës 19.08.2024, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt**

1. Miratohet Kërkesa e Menaxherës së Kontratës, për aprovimin e ndryshimeve në projektin: "**Participimi me donatorë – Parkingu i gjelbërt në qendër të qytetit të Kamenicës - Ritenderim**", me Nr. të prokurimit: **KM653-23-10804-5-2-1**.

2. Ndryshimi i sasive në pozicione brenda kontratës është inicuar nga Menaxherja e Kontratës për projektin e sipërcekur lidhur me ndryshimet në këtë projekt dhe e njëjta është aprovuar nga Hartuesi i Projektit, Mbikqyrësi i Menaxheres së Kontratës dhe Kryetari i Komunës në pajtim me dispozitat e nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit, menaxherja e Projektit dhe mbikëqyrësi i projektit.

4. Kryetari i Komunës bazuar në kërkesën e lartcekur vendosi si në pikën (1) një të këtij vendimi.

5. Vendimit i bashkangjitet Kopjet nga Email-i Zyrtar i datës 08.08.2024 nga Menaxherja e Kontratës znj.Vjollcë Kryeziu për kërkimin e ndryshimeve të sasive të pozicioneve brenda kontratës, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Hartuesi i Projektit Arhiko ING e datës 12.08.2024, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Mbikqyrësi i Menaxheres së Kontratës e datës 19.08.2024, Aprovimin përmes Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës e datës 19.08.2024.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

***Vendimi t'i dërgohet:*** Zyrës së Kryetarit, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, Hartuesit të Projektit "Arhiko ING" (selia Prishinë), Menagjerës së Projektit znj.Vjollcë Kryeziu, Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të Menaxherës së Kontratës z.Blerant Mujaj dhe QSHQ – Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA KOS…
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26919
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 22/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.333, datë:21.08.2024**

Bauzar në nenin 13, nenin 17 shkronja b), nenin 58 shkronja i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), neni 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Proceduren e Përgjithshme Administrative, neni 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1, Neni 6 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.2, neni 11 dhe neni 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 të datës 23.08.2013, neni 2, neni 5, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Nenin 5 paragrafi 5.1 shkronja b), neni 70 paragrafi 70.1 shkronja i) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë,

**VENDIM**
**PËR THEMELIMIN E EKIPIT KËSHILLUES TË KOMUNITETIT**

**1.** Me këtë vendim Formohet Ekipi Këshillues i Komunitetit në këtë përbërje:

**2.** Këshillat Lokale të Komunës, përfaqësuesit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Këshilli Lokal - Qendra Kamenicë, Rubovci | Ruzhdi Qehaja |
| 2 | Këshilli Lokal –Lagjja Malësia-Kamenicë, Tugjec, Gmicë, Zajqec, Meshinë | Murat Demaj |
| 3 | Këshilli Lokal –Lagjja Iliria-Kamenicë | Agim Maliqi |
| 4 | Këshilli Lokal –Lagjja Çamëria-Kamenicë, Hajnoc | Burim Imeri |
| 5 | Këshilli Lokal – Hodonoc, | Sinan Morina |
| 6 | Këshilli Lokal –Berivojcë, | Ilir Tahiri |
| 7 | Këshilli Lokal –Koretin, | Isuf Canaj |
| 8 | Këshilli Lokal –Topanicë, | Mumin Zubaku |
| 9 | Këshilli Lokal –Petroc, | Xhavit Ajeti |
| 10 | Këshilli Lokal –Karaqevë e Epërme, | Rabit Kastrati |
| 11 | Këshilli Lokal –Karaqevë e Poshtme, | Selver Lenjani |
| 12 | Këshilli Lokal –Rogoçicë, | Jeton Kryeziu |
| 13 | Këshilli Lokal –Muçiverc, Dajkoc, Qarakoc, Krenidell | Albert Thaqi |
| 14 | Këshilli Lokal –Shipashnicë e Poshtme, | Islam Rexhepi |
| 15 | Këshilli Lokal –Shipashnicë e Epërme, | Rabit Dërmaku |
| 16 | Këshilli Lokal –Boscë,Grizimë,Strelicë,Moqar, Bratiloc,Feriqevë,Konstadincë | Bojan Stojanovic |
| 17 | Këshilli Lokal –Hogosht, Dazhnicë, Poliqkë, Marovcë, Vriqec, Velegllavë e epërme, Lisockë, Zhujë, Shahiq, Gjyrishec | Sejdi Latifaj |
| 18 | Këshilli Lokal –Kopërnicë, Kolloleq | Endrit Beqiri |
| 19 | Këshilli Lokal –Strezoc, Krilevë, Leshtar, Vaganesh, Rahovicë, Kremenatë I, Kremenatë II, Gragjenik | Besim Cakolli |
| 20 | Këshilli Lokal –Busavatë, | Feim Maliqi |

**3.** Shoqëria civile , përfaqësuesit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | OJQ ProActive | Lavdim Klaiqi |
| 2 | OJQ DardanaPress | Sherafedin Vranja |

**4.** Grupet fetare, përfaqësuesit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Bashkësia Islame | Hoxhë Bujar Fera |
| 2 | Kisha Ortodokse | Protojerej, Srdjan Milenkovic |

**5.** Shoqatat profesionale & bizneset, përfaqësuesit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Shoqata e Bletareve | Mitat Jerliu |
| 2 | Shoqata e Pronareve te Pyjeve Private | Hamit Pireva |
| 3 | Biznes Kosova Tourism | Nexhmije Kallaba |

**6.** Ekspertet e fushave (Arkitektet, Gjeografet, Historianet, Arkeologet, etj)

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Gjeolog | Refik Latifaj |

**7.** Përgjegjësitë e Ekipit Këshillues të Komunitetit:

- Të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative;
- Të kontribuojë aktivisht në debate, të përcjellin informatat rreth zhvillimeve gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës (HZK) tek grupet e interesit që përfaqësojnë.
- Puna e anëtareve të Ekipit Këshillues të Komunitetit për hartimin e të Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës (HZK) bëhet në baza vullnetare, për të mirën e përgjithshme për Komunën e Kamenicës.

**8.** Përgjegjës për zbatimin e Vendimit është Ekipa Komunale e formuar si në pikën 1 (një) të këtij Vendimi.

**9.** Mandati i Ekipit Këshillues të Komunitetit përfundon me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës (HZK).

**10.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Anëtarëve të Ekipit Këshillues të Komunitetit; dhe
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 26947
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 22/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.334 datë:22.08.2024**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.26911 e datës 22.08.2024, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Blerja e mjeteve motorike"**, me numër të kontratës **KM653-24-2181-1-2-1,** si në vijim:

   **1.1.** **z. Burim Krasniqi** (DSHPAI) , CAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** **z. Enver Ismajli** (DSHPAI), CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*T'i dërgohet:*

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z.Burim Krasniqi (DSHPAI);
- z.Enver Ismajli (DSHPAI); dhe
- QSHQ-arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E KAMENICËS - KRYETARI - PREDSEDNIK OPSTINE - REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 27412
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 26/08
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.335, dt.23.08.2024**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008"), Shkresën Nr.400-524/1 të datës 22.08.2024 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nenit 70 paragrafi 70.1 shkronja c) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

1. FORMOHET Komiteti Koordinues për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023 – 2025 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, me këtë përbërje:

   **1.1.** Lidiona Marovca, Zëdhënëse e Komunës; Kryesuese;
   **1.2.** Valdete Berisha Murina, Zyra e Informimit, Anëtare;
   **1.3.** Rona Myrtaj, Zyra e Informimit; Anëtare;
   **1.4.** Sherafedin Vranja, Shoqëria Civile, Anëtar; dhe
   **1.5.** Lavdim Klaiqi, Shoqëria Civile, Anëtar.

2. Komiteti Koordinues për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023 – 2025 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur do të udhëhiqet nga Kryetari i Komunës, me qellim të rritjes së efikasitetit të punës së Komitetit.

3. Komiteti i formuar me pikën (1) një të këtij vendimi, ka për detyrë të bashkëpunojë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për zbatimin e katër zotimeve kryesore nga plani i veprimit, duke përfshirë: Qeverisja Dixhitale, Të dhënat e Hapura, Pjesëmarrja Qytetare dhe Kundër Korrupsioni.

4. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është komiteti i formuar si në pikën (1) një të këtij vendimi.

5. Komiteti për punën e vetë i raporton Kryetarit të Komunës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi t'i dërgohet**:Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komitetit, znj.Nazmije Krasniqi (MAPL) dhe Q.SH.Q - arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E KAMENICËS – 02 KRYETARI I KOMUNËS – REPUBLIKA SRBIJA OPSTINA KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 27462
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 26/08
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.09 Nr.198, datë: 26.08.2024**

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe neni 53, paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Vendimit Sh.02. Nr.20609 i dates 26.06.2024 për themelimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. **NDRYSHOHET** dhe **PLOTËSOHET** paragrafi (2.1) dy, nën paragrafi (2.1) dy pikë një i Vendimit **Sh.02.Nr.20609 të datës 26.06.2024** për themelimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, dhe ***riformulohet*** si në vijim:

   **1.1.** Në paragrafin (2) dy, nën paragrafi (2.1) dy pikë një, në vend të Kryesuesit të Komisionit Komunal z. Naser Vllasi, caktohet Kryesues në Komisionin Komunal znj. Florentina Kryeziu.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.20609 të datës 26.06.2024 për themelimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3. Për Punët dhe Detyrat të i referoheni Vendimit Bazë Sh.02.Nr.20609 të datës 26.06.2024 për themelimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

4. Vendimit i bashkangjitet, Vendimi Sh.02.Nr.20609 të datës 26.06.2024 kopje.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Drejtorit të DSHPAI-së;
- z.Nasr Vllasi;
- znj. Florentia Kryeziu;
- Anëtarëve të Komisionit (Vendimit Bazë Sh.02.Nr.21334 te datës 04.07.2024) ; dhe
- QSHQ – Arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Br. 02 Nr. Br. 27473
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 26/08
KAMENICË/A 2024

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.nr.336, datë 26.08.2024**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 70 shkronja g) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe nenit 4 paragrafi 4.2 të Marrëveshjës së Bashkëpunimit Sh.02.Nr.26724 të datës 21.08.2024 e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Fondacioni Jeshil për Zbatimin e projektit "Menaxhim Qarkor i Mbeturinave Organike në Kamenicë (Circular Biowaste Mannagmement in Kamenica), Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**

**Për Caktimin e Personit Kontaktues për Komunikimin, Koordinimin e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Organizatës Joqeveritare Mjedisore Fondacioni Jeshil**

1. Me këtë Vendim, z. Hysen Jerlliu (DSHPAI), Caktohet Person Kontaktues që do të jetë përgjegjëse për komunikimin dhe koordinimin e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Organizatën Joqeveritare Mjedisore Fondacioni Jeshil.

2. Personi kontaktues do ti kryej detyrat dhe përgjegjësit për realizimin e aktivitetit të planifikuar në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Organizatës Joqeveritare Mjedisore Fondacioni Jeshil.

3. Vendimit i bashkangjitet Marrëveshja e Bashkëpunimit Sh.02.Nr.26724 të datës 21.08.2024 e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Fondacioni Jeshil për Zbatimin e projektit "Menaxhim Qarkor i Mbeturinave Organike në Kamenicë (Circular Biowaste Mannagmement in Kamenica).

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet***: Zyrës së Kryetarit; Zyrës për Informim, z. Hysen Jerliu (DSHPAI), z. Xhevdet Gegollaj OJQ Fondacioni Jeshil (Rr.Ismail Dumoshi 120, 10000, Prishtinë) dhe QSHQ-arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**